

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Mevlide Shabani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve H. G., nga Gjilani, rruga Ismail G., M. G. dhe Xh. G., që të tre nga R. e Turqisë, e të cilët i përfaqëson me autorizim paditësi i parë H. B., e këtë e përfaqëson Hamdi Jashari, jurist i diplomuar nga Gjilani, kundër të paditurës R. J., nga Gjilani, tani me vendbanim në Serbi, të cilën e përfaqëson av. Goran Milenković, nga Shtrpca, sipas projektit për ndihmë juridike, për vërtetimi i të drejtës së pronësisë, në prezencë të paditësve dhe përfaqësuesit të tyre, përfaqësuesit të paditurës, me datë 16.12. 2013, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësve H. G.-B., nga Gjilani, I. G., M. G. dhe Xh. G., që të tre nga R. e Turqisë, me të cilën kanë kërkuar që tu njihet e drejta e pronësisë në qertifikatën mbi të drejtat e pronës me nr. UL-70403013-00786, në vendin e quajtur Jaruge, ZK.Gjilan dhe numër të njësisë P-70403013-892-0, në sipërfaqe prej 9301 m², P-70403013-893-0, në sipërfaqe prej 3362 m², dhe P-70403013-894-0, në sipërfaqe prej 3502 m².

II. Aktvendimi mbi masën e përkoshme c.nr.181/2000, i datës 29.07.2002, lihet në fuqi gjersa aktgjykimi të merr formën e prerë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi I. G., nga R. e Turqisë, përmes përfaqësuesit, djalit të tije H. G.-Bunjaku, nga Gjilani, rr., me datë, 08,09,2000, ka parashtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurve Zh. J. dhe R. J., nga Gjilani, për vërtetimin e pronës duke theksuar se është pronar i palujtshmërisë së ngastrave kadas. me nr. 892, 893, dhe 894, në vendin e quajtur "Jaruge", në Gjilan, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.61,65 ha, në bazë të kontratës mbi shitblerjen, e vërtetuar në gjykatën e rrethit në Gjilan. Vr.nr. 140/46, prej 02.10.1946, duke shtuar se pasi që nuk kan mundur ti plotësojnë kërkesat e pushtetit të atëhershëm për grumbullimin e teprikes, në vitin 1950, kjo palujtshmëri u është marrë duke kaluar në emër të paraardhësve të paditurve e për të cilën pretendojnë se e njëjta duhet tu kthehet.

Paditësi me anë të parashtrësës me nr. 181/2000, të datës 27.07.2001, në gjykatë ka paraqitur propozimin mbi shqiptimin e masës së përkoshme, lidhur me palujtshmërin kontstuese.

Pas vdekjes së paditësit I. G., me parashtrësen e dorzuar në këtë gjykatë përfaqësuesi i paditësve av. Kadri Sylja, nga Gjilani ka bërë precizimin e padis me ndryshimin subjektiv të sajë ku si paditës kan vazhduar të jenë djemt e paditësit H. I. M.

dhe Xh. G., të cilët me autorizim i ka përfaqësuar vëllau i tyre tani paditësi i parë, H. G. –B., ndërsa si e paditur ka mbetur R. J..

Pasi që e paditura R. J., nga Gjilani, nga viti 1999, ishte shpërngulur në Serbi, me adresë të pa njohur për gjykatën, gjyqtarja me parashtresen e dat. 13.02.2013, i është drejtuar zyres për ndihmë juridike në Graçanicë, me qëllim që procedura lidhur me këtë qështje juridike të vazhdojë më tutje parashtresës ja ka bashkangjitur edhe aktvendimin mbi përgjegjien në padi.

E paditura R. J., e ka kundërshtuar kërkespadin e paditësve si të pa bazuar duke theksuar se pasurin tani kontestuese e ka fituar në mënyr të ligjshme përmes kontratës mbi shitblerjen e palujtshmëris të lidhur me 25.12.1965, të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Gjilan.

Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i paditësve Hamdi Jashari, jurist i diplomuar, nga Gjilani, ka mbetur në tërsi pranë padis dhe kërkespadis si dhe thënieve nga seancat e kaluara duke shtuar se në bazë të provave materiale dhe deklaratave të dëshmitarëve është vërtetuar se në bazë të kontratës mbi shitblerjen e palujtshmëris të dat. 01.10.1946, të lidhur në mes të babait të paditësve I. R. që në atë kohë e kishte atë mbiemër , si blerës dhe shitësve Zh. dhe J. S., që të dy nga Gjilani, e kishin blerë palujtshmerin tani kontestuese e që pushteti i atëhershëm serb ua kishte marrë familjes së paditësve dhe të njëjtën ua kshte dhënë familjes Jankoviq, nga Gjilani, duke shtuar se paditësit edhe pse kanë qenë të rrezikuar as një herë nuk kan hequr dorë nga kjo palujtshmeri, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësve ta aprovoj në tërsi si të bazuar.

Përfaqësuesi i të paditures, av. Goran Milenkoviq, në seancen e shqyrtimit kryesor të dat.16.12.2013, ka mbetur në tërsi pranë përgjegjies në padi dhe thënieve nga seancat e mbajtura duke i propozuar gjykatës që kërkespadin e paditësve ta refuzojë në tërsi si të pa bazuar, respektivisht të njëjtën ta hudhi si të pa lejuar pasi që me vendimin e Komisionit Për Kërkesa Pronsore Juridike, prej 01.11.2011. nr. KPA00081 është vërtetuar se tani e paditura R. J., është pronare e kësaj palujtshmerie tani kontestuese, duke shtuar se këtë vendim e ka vërtetuar edhe Kolegji Për Ankesa në Dhomën e Veçantë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili vendim gjindet edhe në shkresat e lëndës, më tutje përfaqësuesi i të paditures ka deklaruar se paditësit me as një provë nuk kanë arritur ta dëshmojnë të drejtën e pronësisë e cila është në pronësin e të paditurës e që paraardhësit e sajë e kanë fituar në bazë të kontratës mbi shitblerjen, e lidhur në gjykatën Komunle në Gjilan, më 28.12.1965, dhe e vërtetuar si II. Vr.125/65, e që në bazë të kësaj kontrate në DGJKPB në Gjilan, është regjistruar si pronare e së njëjtës dhe këtë të drejtë deri në përfundimin e luftës në Kosovë, as kush nuk ua ka kontestuar.

Në fund përfaqësuesi i të paditurës i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë kërkespadin e paditësve si të pa bazuar si dhe i ka propozuar gjykatës që ta lë jashtë fuqie aktvendimi mbi masen e përkohshme .

Me qëllim të vlersimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 16.12.2013, në prani të paditësve, përfaqësuesit të tyre dhe përfaqësuesit të paditures, gjykata bëri administrimin e provave të gjithmbarshme si: kontratën mbi shitblerjen e dat. 1 tetor të vitit 1946 e lidhur në mes të I. R. nga fsh. Desivojcë, si blerës dhe shitësve Zh. dhe J. S., nga Gjilani si shties, kopja e planit në emër të J. J. B. me nr.786, fleta poseduese me nr. 786 në emër

të J. B. e dat. 04.09.2000, tapija e dat. 10 maj 1924, në emër të M. S. dhe A. T. e cila ngastër gjendet në afrësi të Zh. S., raporti i Qendrës për punë sociale në Gjilan me nr.05-80-08 i dt.15.01.2008, njoftimi i shërbimit policor të Kosovës i dt.4.10.2010, fleta poseduese me nr.786 e dt.11.8.2005 në emër të R. J., qertifikata mbi të drejtat e pronës me nr.786 e dt.2.10.2010 në emër të R. J., kontrata mbi shitblerjen e lidhur në emër të I. J. dhe B. J. e dt.28.12.1965 me nr.Vr.125/65, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Gjilan. Qertifikata e lindjes në emër të H. B. e dt.01.08.2012, aktvendimi mbi trashëgiminë i dt.8.05.2012 e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Turqisë, vendimi i Komisionit të kërkesave pronësore të Kosovës me nr.KPCC/D/A/121/2011 e dt.07.09.2011, aktvendimi nga Gjykata Supreme të Kosovës, Kolegji i Apelit të AKP-ës i dt.5.dhjetor 2012 në emër të H. B., vendimi i vërtetuar prej 1.11.2011 nga ana e Komisionit të Agjencisë Kosovare për pronë me shenjën KPCC nr.KPA00081, në emër të R. J., konstatimi i ekspertëve gjeodet Isuf Berisha dhe Mahmut Bajrami i dt.2.10.2013.

Paditësi H. B., në cilsi të palës ka deklaruar se palujtshmërin kontestuese e kanë blerë prej një serbi nga Gjilani, në vitin 1945, ka theksuar se për këtë kanë edhe dëshmi kontratën dhe tapinë, duke shtuar se në vitin 1950, të njëjtën ua kishte marrë shtet-koperativa dhe ja kishin dhënë Zh. J., më tutje paditësi ka dëshmuar se në vitin 1968, babai i tije me familje është shpërngulur në Turqi, e pas asaj kohe tokën e kishin punuar agjallarët dhe kusherit etijë por thekson se e ka shfrytëzuar edhe të paditurit.

Paditësi M. G. B., në cilsi të palës ka deklaruar se ka dëgjuar nga babai i tije se shteti i atëhershëm me dhunë ua kishte marrë këtë palujtshmëri pasi nuk kishin mundur ta paguajn tatimin duke ja dhënë familjes J.. Ka thënë se në vitin 1963, ish-in shpërngulur në Maqedoni e në vitin 1968, në Turqi, më tutje ka theksuar se nga viti 1955, këtë palujtshmëri e kishin punuar pjesë pjesë familja e tije dhe ajo Jankoviq.

Paditësi XH. G. B., ka deklaruar se nga viti 1968, babai i tyre ishte shpërngulur në Turqi, kishte dëgjuar nga babai i tije se e kanë një tokë në Kosovë, të cilën ua kishin marrë serbët, ka theksuar se e ka të njohur se palujtshmërin tani kontestuese e kishin punuar agjallarët e tije e që nga viti 1999, e shfrytëzojnë vëllezërit dhe kusherinjt e tije.

Dëshmitari I. B., ka dëshmuar se ka dëgjuar nga babai i tije se agja i tije Isaku, në vitin 1945, e kishte blerë palujtshmërin tani kontestuese por nuk i kujtohet nga kush, ka dëgjuar se në vitet e 50-ta, pushteti i atëhershëm ua kishte marrë dhe të njëjtën ua kishte dhënë familjes J., nga Gjilani, më tutje ka theksuar se pas asaj kohe edhe pse kishin qenë të penguar e kishin punuar kohë pas kohe, por nga viti 2000, thot se nuk e punon as kush pasi që është kontestuese dhe janë penguar nga policia.

Dëshmitari R. B., ka dëshmuar se ka dëgjuar nga agja i tije Isaku, e kishte blerë këtë palujtshmëri në vitin 1964, nga një serb i fsh. Budrik, e kjo pasuri ju kishte marrë nga pushteti i atëhershëm duke shtuar se as një herë nuk kishin hequr dorë nga kjo palujtshmëri.

Pas vlersimit të provave të administruara si dhe deklaratave të ndergjyqesve, e në kuptim të dispozites së nenit 8 të LPK gjykata vertetoi këte gjendje faktike: Objekt kontesti sipas kësaj lende është palujtshmëria, ngastrat kadast. me nr. 892,893,894, menjë sipërfaqe të tërsishme prej 1.61,65 ha, ZK Gjilan, te cilat në Zyren Kadastrale Komunale evidentohet në emër të të paditurës R. J., fakt i cili nuk ishte kontestues ndërmjet palëve ndergjyqese.

Nga kontrata mbi shitblerjen e dat. 25.12.1965, e lidhur në mes të shitësit I. K. J., nga fsh. Budrikë e Poshtme dhe blerësit B. J. J., nga Gjilani, me nr. II.VR.125/65, gjykata vërtetoi faktin se palujtshmëria –ngast.me nr. 892, në sipërfaqe prej 93.01 ari, në vendin e quajtur Jaruga, është shitur prej 200.000 din, iu është shitur paraardhësit tani të të paditurës B. J. J. dhe gjykata nga e njëjta kontratë ka vërtetuar edhe mënyrën e fitimit të pronsis nga paraardhësi i të paditurës në ngastrën kontestuese me nr. 892 e kjo mënyrë është egzistimi i punës juridike gjegjësisht kontratës së datës 25.12.1965, të përmendur më lartë.

Nga fleta poseduese me nr. 786 e dat.04.09.2000, gjykata vërtetoi faktin se palujtshmëria kontestuese ne vitin 2000,eshte evidentuar në emër të B. J. J., paraardhësit të të paditurës.

Nga fl. poseduese me nr. 786 e datës 11.05.2005 dhe dat.02.10.2010, gjykata kuptoi faktin se e tërë palujtshmëria tani kontestuese evidentohet në emër të të paditurës R. J..

Nga vendimi i KPCC/D/A/121/2011, kërkesa me nr. 00081 gjykata kuptoi faktin se tani e paditura kishte arritur ta provoi faktin e të drejtës pronsore, nga komisioni i kërkesave pronsore, e të cilin fakt nuk kishin arritur ta dëshmoi pala e kundërt e tani paditësi.

Nga aktgjykimi i gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Apelit të AKP-së, me nr. GSK-KPA-79/12 të dat. 5 dhjetor 2012, lidhur me lëndën KPA00081, të datës 7 shtator 2011, gjykata ka kuptuar faktin se është hedhur si e pa lejueshme ankesa e tani paditësit H. B., si e pa lejueshme, pasi nuk kishte qenë palë në procedurë në shkallën e parë.

Nga aktvendimi mbi shqyrtimin e trashëgimis , i dat.22.01.2003, i lëshuar nga Ministria e Drejtësis në Republikën e Turqisë, shërbimi noterial, gjykata kuptoi faktin se tani paditësit, H. I., M. XH. G, janë trashëgimtarë ligjorë të ndjerit Isak Gyndyz, nga Stambolli, r. e Turqisë.

Gjykata ka analizuar edhe kontratën mbi shitblerjen e dat. 1 tetor 1946, e lidhur në mes të blerësit I. R., nga fsh. Desivojcë dhe shitësve Zh. J. S., vëllezër nga nga Gjilani, si dhe tapin e dat. 10 maj 1924, e evidentuar në emër të M. S. dhe Arsenije Tushqiq, gjykata kuptoi faktin se me kënd kufizohen palujtshmërit e që përmendej Zhivko Stoshiq,mirpo nga të njëjtat nuk mund te kuptoi faktin se për te cilën paluejtshmeri ka te bejn, andaj dhe nuk ka mundur ti merr per bazë me rastin e marrjes se këtij aktgjykimi.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratave te deshmitarëve ku deklarojnë se pushteti i atëhershëm ja ka dhënë palujtshmërin kontestuese tani babait të paditëses,sepse keto deklarata jan ne kundërshtim me provën materjale kontratën me nr. Vr.125/65, nga e cila shihet se e paraardhësi i të paditurës e ka blerë ngast.kadas. me nr. 982 dhe nuk ja ka dhënë pushteti i atëhershëm siq deklarojnë.

Nisur nga kjo gjendje faktike e shpjeguar si më lartë gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tersi e pa bazuar dhe ate për këto arsye, paditësit nuk kanë arritur ta provojnë se babai i tyre ka qenë pronar i palujtshmërive kontestuese apo se e ka fituar të drejtën e pronësisë në të njëjtat në ndonjë formë të paraparë me nenin 20 të LMTHPJ. Në kontestet kur kërkohet mbrojtja e pronës dhe lidhur me vërtetimin e pronës dhe dorzimin e palujtshmërive në posedim , paditësi sipas nenit 37 të Ligjit mbi Mardhëniet Themelore Juridiko Pronsore, duhet të provojë që është pronar i sendit me të cilin nënkuptohet edhe vërtetimi i fakteve mbi të cilat bazohet e drejta e tije edhe ate jo vetëm ndaj paditësve por edhe ndaj paraardhësve të tyre .

Paditësit janë të detyruar të provojnë egzistimin e fakteve juridike në bazë të të cilave fitohet , apo në bazë të të cilave mund të fitohet e drejta e kërkuar e pronës . Në rastin konkret paditësit nuk kanë provuar as bazën e as mënyrën e fitimit të pronësisë në palujtshmërin kontestuese. Paditësit vetëm kanë cekë se janë pronar i parcelave kontestuese në bazë të kontratës mbi shitblerjen Vr.nr.140/46, mirpo gjykata konsideron se në bazë të kësaj kontrate paditësit nuk ka mundur ta fitojnë të drejtën e pronësisë sepse nga përmbajtja e së njëjtës shihet se e njëjta kontratë nuk ka të bëjë me palujtshmërit kontestuese. Përveq kësaj gjykata konsideron se babai i paditësve nuk e ka fituar pronësinë në palujtshmërin kontestuese në bazë të kontratës së sipërpërmendur, sepse e njëjta jo vetëm që nuk ka të bëjë me palujtshmërit kontestuese por nuk ka dëshmi e as që është zbatuar në në DGJKPB, e që është paraparë si mënyrë e fitimit të pronësisë në një palujtshmëri konform nenit 33 të LMTHJP.

Paditësit vetëm kanë cekur se janë pronar të palujtshmëris kontestuese mbi bazen e faktit se paraardhësi i tyre I. G. e ka blerë palujtshmërin kontestuese, mirpo e njëjta më vonë i është marrë nga pushteti i atëhershëm dhe iu është dhënë të paditurve mirpo një pretendim të tillë gjykata e quan të pa bazuar ngase nga kontrata mbi shitblerjen nr. II.Nr.125/65, del se pjesa ma e madhe e palujtshmëris kontestuese edhe atëngas. menr.892, me një sipërfaqe prej 93.01 ari, është blerë nga paraardhësi i të paditurës dhe nuk ju është dhënë nga pushteti i atëhershëm siq deklarojnë paditësit, përveq kësaj paditësit me as një provë materiale nuk i kanë provur thënjet e tyre të provuara në padi si edhe gjatë shqyrtimit kryesor.

Pasi që gjykata me aktvendimin c.nr.181/2000, të dat. 27.07.2001, ka aprovuar propozimin mbi caktimin e mas së përkoshme, aktvendimi mbetet në fuqi deri sa ktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Më dat.16.12.2013.

Gj y q t a r j a
Mevlide Shabani d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtijë aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.